

# Si të ndizet zjarri lehtë

## Djegia e drurit me djegie nga poshtë

**Djegia pa tym** – Metoda e re e ndezjes së zjarrit është një mundësi e thjeshtë dhe e efektshme për të zvogëluar lirimin e gazrave të dëmshme gjatë djegies. Në këtë mënyrë druri digjet nga poshtë, lart, njëtrajtësisht në tërë hapësirën e furrës ku digjet. Në krahasim me metodën e zakonshme të ndezjes së zjarrit me anë të kësaj metode do të zvogëlohen mundësitë e rrjedhës kritike të djegies së drurëve dhe gjatë gjithë djegies arrihet një lirim më i vogël i gazrave.

### Për cilat djegie të drurit është kjo metodë e përshtatshme?



Për djegien e drurëve me largim të gazrave nga poshtë (shigjetat)

- djegie nga anash (1)
- djegie nga prapa (2)
- djegie me vrull (3)



**Kaldaja për ngrohje qëndrore**




**Shporeti për ngrohje qëndrore**



**Oxhaku**

### Udhëzim për djegie nga anash (1)




Për një fillim të ndezjes me lirim sa më të vogël të gazrave nevojitet një krijoni nga copat e drurit të pishës së thatë me trashësi maksimale deri 4 cm dhe me një fitil për ndezje. Fitolin duhet ta vendosni ndërmjet dy copave të drurit (shih rrethin e kuq) dhe mu në mes hapësirës, përmes së cilës gazrat largohen nga hapësira e djegies (shih drejtimin e shigjetës).

**Përgatitja:** Përgatitni 6 copa druri – 2 të gjata dhe 4 të shkurtra.

**Mënyra e ndezjes së zjarrit:** Vendosini 6 copat e drurit dhe fitilin për ndezje të zjarrit (shih rrethin) ashtu siç është pasqyruar në fotografinë e mësipërme. Për të lehtësuar ndezjen e zjarrit ju mund të shtyni fitilin dhe dy drurët afër tij pak më përpara.

### Udhëzim për djegie nga prapa (2)




**Përgatitja:** Përgatitni 6 copa druri – 4 të gjata dhe 2 të shkurtra si dhe 1 apo 2 fitila për të ndezur zjarrin.

**Mënyra e ndezjes së zjarrit:** Vendosni copat e drurit dhe fitilin për ndezje (shih rrethin e kuq) ashtu siç është pasqyruar në fotografinë e mësipërme. Nëse pasi të keni palosur drutë nuk mund ta arrini fitilin, vendoseni edhe një tjetër para tij. Fitolin (shih rrethin e ndërprerë) i vini flakën pasi të keni përgatitur skeletin për djegie të drunjve dhe pastaj mbi këtë skelet palosni pjesën tjetër të drunjve.

## Udhëzim për djegien me vrull (3)



**Përgatitja:** Nevojiten katër copa druri të thata pishe me një trashësi 4 x 4 cm dhe me një gjatësi prej 20 cm si dhe fitili për ndezje (p.sh kashta e drurit). Njëra nga copat e drurit mund të përgjysmohet.



**Mënyra e ndezjes së zjarrit:** Vendosni 5 copat e drurit (edhe pjesën e përgjysmuar në pjesën e përpame) dhe fitilin (shih rrethin) ashtu siç është pasqyruar në fotografinë e mësipërme. Fitili duhet të jetë i vendosur në hapësirën në mes të dy drurëve, pjesë nga e cila gazrat largohen nga hapësira e djegies.

## Vendosja e drunjve dhe ndezja e tyre



**Kaldaja për ngrohje qëndrore**  
**Shporeti për ngrohje qëndrore**



**Oxhaku**

Oymyri i drurit të krijuar nga djegia e mëparshme duhet të largohet. Ndërtoni skeletin e djegies së drurit mbi dyshtemenë e furrës. Mbi këtë skelet duhet të vendosni copa të holla druri. Fitili për ndezjen e zjarrit duhet të ndizet me ndonjë shkrepsë të gjatë apo çibrit.

## Këshilla tjera për këtë proces Lutemi të keni parasysh edhe informacionin mbi përdorimin!

### Kaldaja për ngrohje qëndrore

- Programe mbi procedimin: për një djegie me lirim sa më të vogël gazrash është i domosdoshëm një program procedimi, i cili pas fillimit të djegies së drurëve do të reduktojë kapacitetin e ventilatorit djegës. Kërkoni nga furnizuesit me lëndë djegëse instalimin e një programi të tillë.
- Gjydhja e përkohshme: nëse zjarri ndalet ju mund të përdorni dy fitila për ndezjen e zjarrit dhe aktivizojeni ventilatorin 3-5 minuta pasi t'i keni ndezur ato (kjo do të shmangë thymin në dhomë).
- Prushin duhet ta leni të ftohet (rrezik nga zjarri) dhe më së miri largohet me mbeturinat e tjera.
- Pastrimi i rregullt nga pastruesit e oxhaqeve ndikon në lirimin e ulët të pluhurit dhe materieve tjera.

Informacione tjera mund të merrni edhe nga organet tjera kompetente (komuna, kantoni).

Informohuni edhe në këto faqe int.: [www.holzenergie.ch](http://www.holzenergie.ch) [www.fairfeuern.ch](http://www.fairfeuern.ch) [www.umwelt-zentralschweiz.ch](http://www.umwelt-zentralschweiz.ch)

### Oxhaku, shporeti për ngrohje qëndrore

- Hapësirën e furrës për djegie të drurëve mos e mbushni tepër
- Mos e ngulfatni zjarrin duke e mbyllur furnizuesin me ajër ose kapakun e kaminit.
- Për të mbajtur zjarrin ndezur vendosni vetëm nga një copë druri direkt mbi prush. Në oxhak mos hidhni dru më pas.
- Kapaku i ajrit të mbyllët vetëm pasi prushi të jetë pothuajse i shuar. Dera e kaminit të mbyllët vetëm atëherë kur prushi të jetë shuar.

## Çfarë mund të digjet?



- Copa druri, të cilat janë tharë në një vend të mbrojtur mirë.
- Briketts aus naturbelassenem Holz.
- Oxhaku / shporeti për ngrohje qëndrore: gjatësia e copave të drurit nuk duhet të jetë më e gjatë se max. 7-9 cm.
- Druri para se të digjet duhet të ruhet së paku një ditë në një dhomë të ngrohtë. Druri i ftohtë digjet me vështirësi.

**Metodat ndihmëse për të ndezur zjarrin mund t'i gjeni në pikat e shitjes së këtij profili dhe në supermarkete.**



## Çfarë s'mund të digjet?



Për të ndezur zjarrin më të përshtatshme janë fitilat sesa letrat, kartoni, druri nga arkat e përdorura, qeset, druri nga mbylljet etj. Mbetjet e drurit nga ndërtimet e ndryshme nuk janë të përshtatshme për djegie.



Gazrat nga këto djegie dëmtojnë objektet si dhe shëndetin dhe ambientin tonë.

Është e ndaluar të digjen këto materiale.

**Pas 15 minutave djegie pa tym:** Tym do të thotë ndër tjera edhe pluhur i imët. Nëse çdo gjë shkon mirë nga fillimi i djegies së drurit atëherë pas 15 minutave djegia do të pasojë pa tym. Nëse një djegie druri zgjat me tym më shumë se 15 minuta atëherë nuk janë duke u zbatuar rregulloret për mbajtjen e ajrit të pastër (LRV). **Në rast të tillë organi përgjegjës mund të caktojë standarde të tjera apo rregullore-masa tjera.**

### Ky fletëinformacion është përkrahur nga:

Zyra federale për energji BFE dhe Energji Zvicër. Zyra federale për ambient BAFU. Djegia e drurëve Zvicër SFIH. Shoqata e mjeshtërve të pastrimit të oxhaqeve Verband Schweizer Hafner – Plattengeschaefte VHP. Zyrat përgjegjëse kantonale për mbajtjen e ajrit të pastër.

### EnergieSchweiz

Holzenergie Schweiz · Neugasse 6 · 8005 Zürich  
Tel. 044 250 88 11 · Fax 044 250 88 22 · [info@holzenergie.ch](mailto:info@holzenergie.ch) · [www.holzenergie.ch](http://www.holzenergie.ch) · [www.energie-schweiz.ch](http://www.energie-schweiz.ch)  
Publikation-Nr. 316 - 2008/01